Faqja kryesore e internetit të kompanisë, apo siç quhet zakonisht “faqja amerikane” - **www.foreverliving.com** - njofton rreth lajmeve rreth FLP-s nga bota, mënyrave ndërkomëtare të kontaktimit, si dhe informacioneve të tjera me vlerë. Në këtë adresë mund të hyj çdo i interesuar duke klikuar mbi “Guest”.

Në faqen e distributorit mund të hyni duke klikuar mbi „Distributor login”. Këtu mund të shikoni edhe rezultatin e pikëve ditore. Emrin e përdoruesit (LOGIN ID) dhe fjalëkalimin (PASSWORD) për hyrje e gjendeni në fund të llogarisë së bonusave tuaj mujor (llogaria e tregëtarit).

Llogari bonusash në faqen tonë të internetit. Çdo punonjës që zotëron fjalëkalim mund t’i shikoj llogaritë e bonusave të tij mujore në internet.

Rreth përdorimit të këtij shërbimi mund të lexoni në faqen e distributorit të foreverliving.com.

Forever You Tube. Home Office krijoi kanalën e saj Forever You Tube adresa e të cilit është: <http://www.youtube.com/user/AloePod>. Këtu rekomandojmë video prezantuese të produkteve të FLP-s, leksione të managerëve drejtues dhe prezantime të tjera marketingu në gjuhë të ndryshme. Së shpejti na krijohet mundësia e marrjes së mesazheve, si dhe mund të arrihet edhe në Blackberry.

Në lidhje me shfaqjen në internet

të distributorëve përfaqësuesit e kompanisë qëndrore ju thërrasin vëmendjen për çështjet e mëposhtme:

- në faqen e internetit nuk mund të jepen këshilla mjekuese/mjekësore;
- në faqen e internetit nuk mund të bëhen premtime në lidhje me të ardhurat;
- faqja e internetit duhet të përmbaj me çdo kusht që operatori i saj është distributor i pavarur i FLP-s dhe që jkjo faqe nuk është faqe zyrtare e FLP-s;
- në faqen e distributorit nuk mund të bëhen shitje nëpërmjet internetit

Ju tërheqim përsëri vëmendjen se në bazë të pikës 14.3.3.5 të Politikës ndërkomëtare të Biznesit produktet tona nuk mund të shiten as në ankand/treg elektronik (psh. Vatera, Tesz-vesz, E-bay, etj.) Ju lutemi që çdo shfaqje në internet ta planifikoni duke marrë parasysh kriteret e mësipërme, dhe para çdo publikimi mos harroni të kërkonit leje nga Kompania. Linkun e faqes së internetit e presim në adresën qëndrore të email-it flpbudapest@flpseeu.hu.

NJOFTIME

E PARREGULLT!

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseeu.com!

INFORMACIONE ME VLERË

Kompania jonë u ofron Distributorëve të saj mundësi të ndryshme re për të kontrolluar pikët e tyre:

– **Në internet.** Informacionin rreth kësaj e gjeni në pjesën e Njoftimeve me titull INTERNET.

– Informacione rreth pikëve mund të kërkonit edhe nëpërmjet **sistemit-SMS** që funksionon me sukses prej vitesh.

– Edhe punonjësit e **shërbimit telefonik** të zyrës sonë qendrore të Budapestit ju informojnë me kënaqësi rreth të dhënave aktuale të qarkullimit tuaj. Vlerat e pikëve personale distributorët e Budapestit mund t'i pyesin në numrin e telefonit +36-1-269-53-70 dhe +36-1-269-53-71, kurse të Kroacisë, Bosnia-Hercegovinës, Sllovenisë, Serbisë dhe Malit të Zi +36-1-322-55-41.

Ju lutemi të interesoheni vetëm për pikët dhe biznesin tuaj personal!

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar që edhe në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes plotësisht të saktë të formularëve, sidomos të fletës së regjistrimit të distributorit, e cila është kontrata ndërmjet distributorit dhe FLP-s! Formularët e korrigjuar dhe dhe të panëshkruar të regjistrimit dhe porosisë së produkteve nuk mund t'i pranojmë për shkak të shmangjes së gabimeve!

Pranojmë vetëm kontratat me nën shkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallcifikim doku mentash!

Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit s'është e mjaftueshme ta shkruani atë në fletën e porosisë së produkteve. Për këtë ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e kontrollit të pikëve nëpërmjet autorizimit, personi i autorizuar të sjell me vete letërnjoftimin e tij!

Sipas Politikës Ndërkombëtare të Biznesit, çdo distributor që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice direkt nga zyrat. Ndërkohë distributor i regjistruar ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur 2 kopje të formularit të regjistrimit të vulosur dhe dorëzuar më parë.



Program 19 prill - 27 maj 2010

18:00 dhe 06:00	Himni
18:15 dhe 06:15	Dr. Istvan Taraczközy Mënyrë jetese natyrore - Duaje vetveten
18:30 dhe 06:30	Dr. Csaba Gothard Çfarë u bëre Tokë e shtrenjtë?
18:55 dhe 06:55	Dr. Ibolya Bagoly Ushqimi
19:25 dhe 07:25	Yjet e FLP-s I
20:15 dhe 08:15	Supervizorë, asistent menaxherë
20:45 dhe 08:45	Menaxherë, menaxherë drejtues, sundimtarë
21:55 dhe 09:55	Yjet e FLP-s II
22:35 dhe 10:35	Peter Szabo Të bukurat e ndërtimit të skuadrës
22:55 dhe 10:55	Istvan Halmi Zgjero!
23:50 dhe 11:50	Michael Strachowitz Tre çelësat e suksesit
00:40 dhe 12:40	Yjet e FLP-s III
01:40 dhe 13:40	Shpallja e rezultatit të Yjeve të FLP-s
01:50 dhe 13:50	Supervizorë, asistent menaxherë
02:10 dhe 14:10	Menaxherë, menaxherë drejtues, sundimtarë, të kualifikuarit e Brazilit
02:50 dhe 14:50	Agnes Klaj U bëra anëtar i PC
03:10 dhe 15:10	Slavka Mohova dhe Dezső Szabo Motivim nga Çekia
03:55 dhe 15:55	Sandor Toth dhe Edina Vanya Dhurata e planit marketing është profiti
04:20 dhe 16:20	Surprizë (Zsolt Frenko) ABBA
04:50 dhe 16:50	Tasnadi Lajosne, Ilike Çfarë do të thotë për mua niveli i menaxherit?
05:20 dhe 17:20	Robert Varga, Nga hapi në hap në muajt e verës



NJOFTIMET E PËRFAQËSIVE TË HUNGARISË

TË REJA

Që nga dita e sotme Telecenter zotëron numër të ri TË GJELBËR: 06-80-204-983. Ky shërbim funksionon gjatë ditëve të punës në orarin 12-16 dhe mund të telefonohet falas. Natyrisht Telecenter mund të arrihet akoma edhe në numrat e vjetër: +36-1/297-5538, +36-20-456-8141, +36-20/456-8149

KALENDARI I AKTIVITETEVE

BUDAPEST — Success Day: 2010. 05. 22.; Success Day: 2010. 07. 24.; Success Day: 2010. 09. 11.; Success Day: 2010. 10. 16.; Success Day: 2010. 11. 20.; Success Day: 2010. 12. 18.

POROSI PRODUKTESH

Blerësit që i sigurojnë produktet jo personalisht, por me autorizim mund t'i bëjnë porositë e tyre në mënyrën e mëposhtme:

– **në telefon**, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit: +36-1/-297-5538, +36-1/297-5539, cel: +36-20/456-8141, +36-20-456-8149, numri i gjelbër: +36-80-204-983 (mund të telefonohet falas gjatë ditëve të punës në orarin 12-16) – **me sms** në numrin e telefonit +36-20/478-4732. – **në internet**: në faqen www.flpseeu.com! Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt – jo vetëm përsa i përket blerjes së drejtpërdrejtë të produkteve, por edhe regjistrimit të porosisë. Është një mjet i shkëlqyer edhe gjatë rekomandimit të produkteve, pasi kjo ofertë është joshëse për çdo të interesuar. Vlera e pikëve të çdo porosisë brenda 24 orëve i shtohet vlerës aktuale. Dyqani ynë web mund të arrihet drejtpërdrejtë në adresën www.flpshop.hu, kurse vlera e pikëve dhe mund të ndiqet me vëmendje në faqen internetit www.foreverliving.com.

BLERJE ME ULJE

Partnerët tanë me shtetësi hungareze pjesën e shpërblimit që u takon për blerjet personale mund ta marrin në formën e uljes së çmimit. Sipas kërkesës suaj uljen e zbrisim nga shumata e çeqeve të blerjes, kështu që Ju paguani më pak. Procesi i blerjes me ulje është si mëposhtë:

1. Deklarata. Nëse Ju dëshironi ta shfrytëzoni këtë mundësi duhet ta deklaroni këtë duke plotësuar formularin përkatës.

2. Blerja: Sistemi e zbret automatikisht uljen në çmim nga shumata gjithsej. Por kjo shumë për çdo person nuk mund të kalojë 35% të shumës gjithsej neto. Nëse ulja e mbledhur në emrin Tuaj është

më e madhe se kjo shumë, atëherë shumën e mbetur ua llogarisim gjatë blerjes së ardhshme, përsëri deri në vlerën 35% të shumës gjithsej të re, pastaj ky proces përsëritet mëtej. Në rastin e blerjes me ulje nevojitet vërtetimi i identitetit Tuaj ose i personit të autorizuarit me letërnjoftim me fotografi.

3. Informimi: Shumës që mund të merret në përdorim në datën 15 të çdo muaji i shtojmë uljet e reja që rrjedhin nga blerjet e muajit të kaluar. Rreth shumës aktuale të uljes kolegët tanë mund t'ju japin informacione juve ose personit të autorizuar vetëm personalisht, pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi. Për detaje të mëtejshme interesohuni tel sponsorët ose punonjësit tanë.

TRANSPORTI

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Ju i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – në kohë të përcaktuar – në çdo zonë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anulohet dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

INFORMACIONE ME VLERË

I lutemi Distributorëve të Nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre të tregëtisë! Në të ardhmen vetëm me këtë dokument mund t'u japim shpërblime! Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e firmës së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë formularët e nevojshëm të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i firmës. Njoftimi i hollësishëm në lidhje me këtë gjendet në zyrat tona, por me kërkesën tuaj mund t'ju njoftojnë edhe gojarisht.

Numrat telefonik të specialistëve tanë mjek:

Dr. Kassai Gabriella +36-20/234-2925
Dr. Kozma Brigitta +36-20/261-3626
Dr. Mezösi László +36-20/251-9989
Dr. Németh Endre +36-30/218-9004
Siklóndi dr. Révész Edit +36-20/255-2122

Numri telefonik i specialistit tonë mjek të pavarur:

Dr. Bakanek György +36-20/365-5959

Produktet e Forever Living Products i nxjerrim në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

PËRFAQËSITË TONA

Forever Living Products

• Qendra Mësimore:

1067 Budapest, Szondi utca 34.
tel.: +36-1/332-5956, +36-20/253-3614

Menaxher projekti: Dr. Gothárd Csaba
Ndryshon orari i hapjes së magazinës së rrugës Szondi: H-P: 10:00-21:00

• Drejtoria Qendrore e Budapestit:

1183 Budapest, Nefejeics u. 9–11.
E-mail: flpbudapest@flpseeu.hu
Tel.: + 36-1- 291-8995, + 36-20-465-6280

Drejtor gjeneral: Dr. Miliesz Sándor

Drejtor i ekonomisë: Kádás Rudolf

Tel.: + 36-1-291-8995/103

Drejtor i financës: Rókasné Véber Gabriella

Tel.: + 36-1-291-8995/171-es mellék

Drejtor kontroli: Suplicz Zsolt

Tel.: + 36-1-291-8995/181

Drejtor i Informatikës, Llogarisë dhe Çështjeve

Ndërkombëtare: Ladák Erzsébet

Tel.: + 36-1-291-8995/160

Drejtor i çështjeve të sigurisë dhe personelit:

Huszt Bernadett Tel.: +36-1-291-8995/194

Drejtoria Qendrore (Sekretaria):

Gerő Zsuzsa +36-1-291-8995/158,

mobil: + 36-20-593-8205

Kismárton Valéria me kodin 107,

mobil: + 36-20-572-2964

Petróczy Zsuzsanna me kodin 106,

mobil: + 36-20-230-9759

Vida Mónika me kodin 159,

mobil: + 36-20-200-3303

• Drejtoria Rajonale e Debrecenit:

4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.

tel.: +36-52/349-657, +36-20/914-2945

Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.

• Drejtoria Rajonale e Szegedit:

6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.

tel.: +36-62/425-505, +36-20/251-1712

Drejtori i rajonit: Radóczy Tibor

• Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit:

8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3.

tel.: +36-22-333-167, +36-20/467-8603

Drejtori i rajonit: Kiss Tibor

Forever Resorts

• Hoteli Kështjella e Szirakit

3044 Szirák, Petőfi u. 26.

tel: +36-32-485-300,

fax: +36-32-485-285.

Drejtoresha e hotelit: Király Katalin

Faqja e internetit: www.kastelyszirak.info



DENVER COLORADO



MAKE A DIFFERENCE
SUPER RALLY 2010
FOREVER LIVING PRODUCTS



12-14 GUSHT 2010



NJOFTIMET E ZYRAVE



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381 11 3970 127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381 18 514 130, +381 18 514 131.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.

Zyra e Horgoshit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381 24 792 195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme:

bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309 63 82. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

– Pagesa e produkteve bëhet pasi ato merren në dorë.

Vlera e transportit është 600 dinar dhe paguhet nga porositësi.

– Shpenzimet e postës duhen paguar në bazë të kursit të parasë në Serbi në ditën që ndodh marrja e mallit, dhe ato merren përsipër nga FLP-ja e Beogradit vetëm në rastin kur vlera e porositës së bërë është më e madhe se 1 pikë.

– Nuk mund të bëhet regjistrim nëpërmjet telefonit.

– Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.

– Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash, fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Biserka Lazarević dhe dr. Predrag Lazarević:

+381 23 543 318

Të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00 presin thirrjet tuaja për konsultim.

Dr. Božidar Kaurinović:

+381 21 636 9575

Të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret ethirrjet tuaja për konsultim.



MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20. tel. +382 20 245 412, tel./fax: +382 20 245 402.

Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00. Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00. E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00.

Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakić

– Porosi produktesh mund të bëni në numrat telefonik të mëposhtëm: +382 20 245 412; +382 20 245 402.

Pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e produktit të porositur e kalon 1 pikë, shpenzimet e transportit i merr përsipër FLP-ja.

Numri i telefonit i specialistes mjek:

Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127



SLLOVENIA

Zyra e Ljubllanës: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3., tel.: +386 1 562 3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

Adresa e magazinës së Lendavait: 9220 Lendava, Kolodvorska 14.. tel.: +386 2 575 12 70, Fax: +386 2 575 12 71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit në rastin e porosive telefonike është: +386 1 563 7501. Në rastin e porosive telefonike, mallin e dërgojmë në adresën që i përket kodit. Distributorët që duan të porosisin mall në emër të një distributori tjetër, duhet të kenë autorizim nga distributori në emrin e të cilit duan të bëjnë porosinë. Formularët e autorizimit mund të sigurohen në zyrë. Malli i porositur në telefon transportohet për dy ditë pune!

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Arbeiter Miran: +386 4142 0788



JUGLINDORE



KROACIA

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.
tel: +385 1 3909 770; Fax: +385 1 3909 771
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 09.00–20.00;
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00.

Zyra e Rijekës: 51000 Rijeka Strossmayerova 3/A.
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 12.00–20.00;
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00
tel: +385 51 372 361, +mobil: +385-91/455-1905

Drejtori i rajonit: Dr. Laszlo Molnar

– Porosi telefonike: +385 1 39 09 773,
+385 1 39 09 775.

Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti,
çmimi i transportit paguhet nga FLP Kroacia.

– Leksionet në lidhje me njohjen e produkteve: të hënën, të
martën dhe të mërkurën 17.00

– Nëse vlera e blerjes është më e madhe se 1500 kuna ekziston
mundësia e pagesës në dy-tre pjesë me kartën Diners Club.

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Ljuba Rauški Naglic,
mobil: 091 51 76 510

Në ditët teke në orarin 16.00–20.00.



BOSNIA-HERCEGOVINA

Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.,
tel: +387 55 211-784, +387 55 212-605, fax: +387 55 221 780.
Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akita Šeremeta do br. 10., tel.:
+387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651. Orari i
hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00–16.30, të martën, të
mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit (ditë
pune) organizojmë një Ditë Sukses mini në zyrën e FLP-s.

Drejtoresha e zyrës: Enra Hadžović

– Në zyrat e Bosnies porositë telefonike mund të bëhen në
numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk
mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387 55 211 784,
Bijelinë dhe +387-33-760-650 Sarajevë.

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Nišić Ema +387 62 367-545, e cila gjatë ditëve të
punës punon në orarin 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja-specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban
konsultime në zyrën e Sarajevës në orarin 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli.
Nëse vlera e porosisë nuk është më e madhe se 1 pikë krediti,
atëherë shpenzimet e transportit paguhet nga distributori.



SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Tiranë, Reshit Collaku 36. tel/fax: +355
42230 535.

Drejtori rajonal: Attila Borbáth

Drejtori i zyrës: Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355 694 066 811.
Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20,
e-mail: fpalbania@abcom.al



KOSOVA

Pristinë Rr. Uçk br. 94, tel.: +381 38 240 781,
+377 44 503 911.



Ndërtojme URË DREJT NJERËZVE

Istvan: Teca Harman dhe Tamas Biro na u ngjitën nga pas derisa i pyetja që sa para kishin bërë gjatë një viti e gjysëm që merreshin me mua. (Unë e kisha në dorë përgjigjen, që e shikoni pra, prandaj nuk na intereson.) Nxorrën letrat, mblodhëm dhe rezultati ishte 20 milion forinta. Kështu që nuk morrën përgjigjen e planifikuar, por pyetjen që çfarë duhet të bëjmë për ta arritur këtë?

Përse e shtytë kaq shumë?

Rita: Më parë kishim marrë pjesë në një firmë tjetër MLM, ku punuam shumë, por nuk e arritëm dot atë që kishim parashikuar, prandaj me vetëdije nuk donim të merreshim më me diçka të tillë.

Pra, e dinit se si është shitja e sistemit MLM. Çfarë të reje solli Forever Living Products?

Istvan: Në firmën e parë duhet të shtonim kërkesën. Këtu kjo gjë nuk nevojitet, sepse kërkesa për këto produkte ekziston tek çdo njeri. Ne duhet vetëm të informojmë, asgjë tjetër. Duhet të tregojmë faktet dhe të jemi simpatik. Dhe dalëngadalë të gjithë e kuptojnë që shëndeti i tyre nuk varet nga të tjerët, por e kanë vetë në dorë. Nëse informoni dhjetë njerëz, pesë prej tyre u intereson, dhe dy prej tyre do të bëhen klientë. Jam i bindur që këtë do e bënte me sukses edhe ai që nuk e kryen mirë punën, sepse produktet janë të mira, dhe jemi të detyruar t'i përdorim ato në interes të shëndetit tonë.

Thonë që fuqia e tyre është fakti që punojnë së bashku: kudo që shkojnë, shkojnë së bashku, dhe kjo e forcon marrdhënien e tyre. Inxhinieri i aviacionit Halmi Istvan dhe pedagogia Rita Mikola Halmine e filluan biznesin e FLP-s para 11 vitesh. Sot ndodhen në vend të katërt në bazë të rezultateve të biznesit, dhe në vend të parë si çift bashkëshortor.







Por prapë kandidatët e rinj shpeshherë shmangen...

Istvan: Njerëzve nuk u pëlqen të bindin të tjerët. Por këtë bën gjithë bota, të gjithë shesin diçka dhe të gjithë blejnë. Nëse jo gjë tjetër, vënë në shitje forcën e punës, „u shesin vetveten” le të themi për tetë orë në ditë shefit të tyre. E vështira në këtë nuk është shitja, por krijimi i marrdhënieve dhe ruajtja e tyre për afat të gjatë kohe.

E kishit më të lehtë punën nga fakti që kishit punuar edhe më parë si tregëtar – në disa fusha.

Istvan: Kjo më tepër na e vështirësoi punën, sepse ishim mësuar të bënim gjithçka vetë, por këtu s'është kështu. Kurse nga ana tjetër i kishim kaluar të gjitha gabimet e mundshme dhe i dinim rregullat bazë. Natyrisht brenda një kuadri të caktuar ekziston një hapsirë e gjerë që njeriu të jetë kreativ, pasi ndërtojmë urë drejt njerëzve, dhe për këtë ekzistojnë me miliona mundësi.

Cili është elementi special Halmi në biznes?

Istvan: Gjëja plus që na ndryshon ne nga të tjerët jepet nga Rita. Delikatessa, mikpritja, stili i saj. Kur organizojmë aktivitete, lektorët priten me emrat e tyre dhe bombone në karrige, tryezë VIP me pije, kafe dhe ëmbëlsira. Ka shumë rëndësi atmosfera ku ndodhen dhe përshtypjet me të cilat largohen. Rita i gjen edhe skenës gjithmonë pamje të ndryshme.



Dhe përsa i përket zgjedhjeve profesionale?

Rita: Forca jonë është profesionizmi i Istvan-it i cili e dallon mirë stilin, personalitetin e njerëzve, dhe u përshtatet mirë atyre. Nëse kandidati është një student, edhe me të komunikon njëllor si me një profesor apo tregëtar të madh. Kja natyrisht jepet nga përvoja e viteve dhe seria e disfatave.

Istvan: Në fillim kishim një skuadër serioze tek e cila m'u duk se kisha gjetur njerëz fantastik, të cilët që atëherë nuk i kam parë më. Sepse bëja mbledhje tradicionale firme, dhe nëse dikush nuk e bënte mirë i flisja. U bëra shefi i tyre, dhe mendoja se kjo ishte diçka e mirë. Unë isha i zellshëm, vetëm që nuk po shikoja që njerëzit tremben dhe largohen nga kjo. Sot e di, që ka njerëz tek të cilët duhet të jesh shef, por ka të tjerë tek të cilët ky është gabim i madh.

Na trego edhe ne të lutemi disa prej sekreteve të tua!

Istvan: Lavdëro, pyet dhe mos debato. Këto tre këshilla janë baza e gjithçkaje. Nëse dikush i zbaton këto nuk i mbeten shumë pengesa. Pasi çdo njeri dëshiron të shfaqet, t'i përforcohen veprimet e bëra, të lavdërohet për veshjen, flokët dhe paraqitjen e tij... As ne nuk bëjmë përjashtim, edhe mua më vjen mirë kur më lavdërojnë gruan, makinën, rezultatet e biznesit tim. Këtu qëndron edhe rëndësia e të pyeturit: njerëzit nuk janë kureshtar për tjetrin, por për vetveten. Po ta vësh re kur kthehesh nga jashtë asnjëri nuk të bën më shumë se dy pyetje, dhe nga ana tjetër të tregojnë me hollësi se çfarë ka ndodhur në shtëpi.

Mosdebatimi është për t'u habitur, pasi në bisedën e parë përballen gjithmonë

argumente dhe kundërshtime, apo jo?

Istvan: Nëse e kryen mirë punën, nuk është kështu. Nëse dëshiron të shprehësh një mendim tjetër dhe e bën këtë, krijohet një betejë. Asnjëri nuk mund të bindësh për asgjë, më mirë mund të themi: dikush bindet vetë për diçka. Kështu që e pranojmë pikëpamjen e tjetrit, më e shumta e plotësojmë pak.

Faktin që u bëtë menaxher për një kohë rekord, brenda 51 ditësh, madje shkuat si menaxher në ditën e parë të suksesit të jetës suaj, ia dini për nder marrdhënieve tuaja të mëparshme?

Istvan: Po, megjithatë nga biznesi ynë i mëparshëm nuk sollëm asnjëri me vete. Këtë sukses ia dimë për nder sponsorit tonë të atëhershëm, Tamas, dhe drejtuesve të shkëlqyer. Csaba Toth dhe Dr. Zsolt Gönczi. 51 ditë vetëm në aparençë, pasi ne e kishim paguar më parë çmimin e suksesit.

Kishit punë më të vështirë se sa po të jetonit në kryeqytet?

Istvan: Po, nga njëra anë sepse në Budapest jetojnë 2 milion njerëz, ndërkohë që në Miskolc vetëm 200 mijë, nga ana tjetër në Miskolc atëherë ekzistonin dy menaxherë, ne duhet të ndërtonim gjithë infrastrukturën me aktivitete, magazinë dhe prezantime. Por kjo ka disavantazhe edhe avantazhe, pasi njeriu i përgjegjshëm bën gjithmonë më shumë se sa ai që vetëm i shijon gjërat.

Në krahasim me këtë ritëm është për t'u çuditur që pas një viti e gjysëm dhe tre menaxherëve që dolën prej jush, hoqët dorë për një vit e gjysëm.





*„Njeriu i
përgjegjshëm
bën gjithmonë
më shumë se sa ai
që vetëm i shijon gjërat”*

Rita: Bëmë pak pushim. Djali ynë Bence atëherë nisi karrierën e shahut, shkruam në konkurse ndërkombëtare, kampionate europiane dhe botërore, si dhe prisnim djalin e vogël Bajnok. Burri im kur lindi Bence punonte shumë dhe kalonte shumë pak kohë në shtëpi. Tani vendosi që të mos mbetet jashtë kënaqësive të prindit, dëshiron të jetë i pranishëm kur i bëjmë banjë.

Bence dhe Bajnok: të dy emrat do të thonë kampion.

Rita: Kjo është sidomos e vërtetë në rastin e Bajnok-ut, pasi kemi luftuar shumë për të. Ishte një mrekulli e vërtetë, edhe gazetaret shkruan rreth tij. Janë të dy kampion, njëri kampion shahu, kurse tjetri kampion jete. Jemi të sigurt që kanë lindur kampion!

Gjithçka vetëm çështje dëshire?

Istvan: Po, kështu mendoj. Njeriu e arrin atë që dëshiron. Ne atëherë donim pikërisht një Kampion, dhe kështu u bë. Gjatë dhjetë viteve nuk morri ilaçe dhe nuk u sëmur asnjëherë. Një fëmijë i vërtetë FLP-je!

Kur u kthyet në biznes, mund ta vazhdonit aty ku e latë?

Istvan: Jo. Më lartë. Gjatë periudhës që nuk punuam, tre menaxherët tanë e morrën seriozisht biznesin.

Thonë që edhe djali juaj i madh e ka marrë seriozisht...

Rita: Po, po përgatitet për t'u bërë anëtar i FLP-s. Tani bëhet 18 vjeç dhe do të marrë si dhuratë një kuti touch. Diskutojmë prej disa muajsh që çfarë liste të shkruaj, cilin dhe si duhet ta ftoj, vjen me ne në

aktivitete... dhe ia ka vënë syrin makinës së tij. Por e tërheq edhe suksesi: frymëzohet shumë kur e njohin shumë njerëz në aktivitete. Njëherë donin të dilnin në fotografi me të, njëherë tjetër e pyetën në internet që ai është djali i Istvan Halmi-t. Këto e motivojnë edhe atë.

Me çfarë e kaloni kohën e lirë?

Rita: Istvan-it i intereson sporti, i pëlqen shumë futbollin, si dhe çdo lloj sporti tjetër. Përveç kësaj mbledh fusha të veçanta shahu, ngado ku kemi qenë ka sjellë një fushë shahu. Mua më tërheq bota e ngjyrave, moda, makijazhi, dekorimi i shtëpisë dhe kopshtet. Përpiqem të zbuloj dhe të mësoj harmoninë e këtyre. Na pëlqen të udhëtojmë bashkë me fëmijët, të dy vetëm ose me shokë.

Istvan: Unë kisha dëshirë të madhe që njëherë të fluturoja mbi Grand Canyon dhe kjo m'u realizua, megjithatë nuk ishte ashtu siç e imagjinoja, pasi avionin nuk e drejtoja unë, por isha një prej shumë turistëve të tjerë.



Edhe në jetë e ke të vështirë kur nuk drejton vetë?

Istvan: Aspak.

Me sinqeritet?

Istvan: Me sinqeritet? Sigurisht. Në biznes dhe në familje besoj tek demokracia: i konsideroj të gjithë si partner, por drejtuesi jam unë.

Tre vjet më parë u bëtë safir dhe në vitin 2009 morrët edhe profit sharing.

Istvan: Për herë të pestë, por kjo ishte më e vështira për shkak të krizës dhe atmosferës publike negative.

Cili është pikësynimi i ardhshëm?

Rita: Na mungojnë edhe pesë fronte menaxherësh për kualifikimin si diamant-safir.

Do e arrini?

Rita: : Sigurisht. Në vitin 2011.

Në fillim patët respekt për ata që kishin bërë një shumë të madhe brenda një viti e gjysëm. Arritët ta tejkaloni këtë?

Istvan: Çeku ynë i Profitit të vitit të kaluar ishte 101 000 euro, kjo – sido që ta llogaris – është më tepër.



SA kohë KE?

“E DO JETËN? ATËHERË MOS E HARXHO
KOT KOHËN, SEPSE AJO PËRBËN JETËN”

Benjamin Franklin

E konsideroj të rëndësishme të flas rreth menaxhimit të kohës, sepse siç e shoh, shumë njerëz vuajnë nga ky problem. Rreziku më i madh i kësaj pune është pavarësia. S’ka shef, s’ka kërkim llogarie. Prandaj duhet të veprojmë vetë – në mënyrë më konsekuente -, pasi koha na rrëshqet nga dora. Kalojnë ditët dhe na duket sikur punojmë shumë, por rezultatet nuk tregojnë këtë gjë. Shumë prej nesh janë të zhgënjyer, por i shkaktojnë vetë disfatat e tyre. Nuk merren me gjërat që i çojnë përpara. Ndryshimi i madh ndërmjet njeriut të suksesshëm dhe të dështuar qëndron në menaxhimin e kohës. Koha është ajo me të cilën duhet të sillemi me shumë zgjuarsis, pasi rrethohemi nga shumë faktorë që na e vjedhin kohën. Angazhimi i ndjerë për pikësynimet tona na detyron ta mësojmë këtë.





MENAXHIMI I KOHËS S'ËSHTË GJË TJETËR VEÇSE DREJTIMI I VETVETES.

1. Dallimi i situatës sonë:

Të vemë re që për çfarë gjërash e harxhojmë kot kohën. T'i shmangim ose t'i pakësojmë këto. Harxhojmë shumë kohë përshembull me kërkimin e gjërave të humbura. Të mbajmë rregull në dokumentat tona. Të mos grumbullojmë kot, të hedhim poshtë gjërat për të cilat s'kemi nevojë.

2. Rëndësia e delegimit:

Të mos e bëjmë atë që mund ta bëjnë edhe të tjerët në vendin tonë. Me këtë mund të kursejmë shumë kohë.

3. Rëndësia e planifikimit:

Duke mbajtur parasysh qëllimet tona të përgatisim planet ditore, javore dhe mujore në bazë të prioriteteve. T'i planifikojmë detyrat tona duke përdorur kalendar dhe t'i klasifikojmë ato për rezultatet pozitive. Të mbajmë shënim se kur dhe për çfarë duhet të kushtojmë vëmendje. 80 përqind të kohës ta kalojmë me gjërat që janë më të dobishme për ne, kurse 20 përqindëshin tjetër me veprimtari të tjera. Çdo ditë ta nisim me një listë të tillë klasifikimi. Pas një farë kohe kjo na bëhet zakon dhe na ndryshon gjithë jeta. Marrim në zotërim minutat tona, dhe nëpërmjet kësaj marrim në dorë drejtimin e jetës sonë. Suksesi dhe dështimi varet nga menaxhimi i kohës. Të jemi të disiplinuar dhe konsekuent. Duhet t'i bëjmë gjërat edhe kur nuk kemi dëshirë; shtytja e gjërave është një zakon i keq të cilin mund ta ndryshojmë. Të ngrihemi shpejt nga gjumi, sepse fitojmë shumë minuta me vlerë. Të shfrytëzojmë momentet e pritjes, të kemi gjithmonë me vete një libër që ta lexojmë në këto raste.

4. Të mos mendojmë vazhdimisht për të kaluarën!

Harroje → mëso prej saj → shiko përpara. Vetëm e tanishmja ka rëndësi!

5. Dhënie shembulli dhe mësimi i të tjerëve:

Nëpërmjet shembujve tanë të nisim ndryshimet e mësipërme edhe në jetën e kolegëve.

Si drejtues i FLP-s edhe unë duhet të mësoja të menaxhoj kohën, pasi në jetën time të mëparshme ma kontrollonin gjithmonë të tjerët. Përcjellja e këtyre përvojave është diçka e mrekullueshme. Falenderoj shumë drejtuesit të cilët ndihmojnë punën time me dhënien e shembullit të tyre, sponsoren time Beata Tasnady dhe linjën e sipërme, Dr. Adolf L. Kosa dhe Tamas Biro.

Këto janë katër shprehje të cilat na e lehtësojnë jetën.

Sa më shumë t'i përdorim, aq më të lumtur bëhemi:

- FALEMNDERIT
- TË DUA
- MË VJEN KEQ
- MË FAL, TË LUTEM

Të kemi guxim t'i përdorim këto, edhe nëse është e vështirë! Dhe keni për ta ndjerë ndryshimin cilësor në marrdhëniet tuaja. Ju uroj suksese të shumta, minuta me vlerë dhe njerëz të lumtur rreth jush.

Erika Tanacs
senior menaxhere



AKTUALE

FALENDERORJ QË MUND TË SHKRUAJ RRETH FESTAVE TË PARA TË KAPITULLIT TONË TË RI PIKËRISHT NË KËTË MUAJ. E DJELA E PARË E MAJIT ËSHTË DITA E NËNAVE, KURSE E DJELA E FUNDIT DITA E FËMIJËVE. TË DYJA FESTAT BËJNË FJALË RRETH DHURIMIT SË JETËS.

Falenderimi i majit

Sytë e mëdhenj blu të përlotur, buzeqeshja dhe dredhja e buzëve sikur dëshiron të qaj... edhe unë vetë e pashë nëpërmjet lotëve djalin tim Gergo kur recitoi vargun e fundit të vjershës së ditës së nënave: "nëna ime, gruaja e parë e jetës sime"

E dhe sot prekem kur e kujtoj, pavarësisht se kanë kaluar njëzetë e pesë vjet. "Fëmija" tani është tridhjetë e tre vjeç, dhe maji është një muaj shumë i rëndësishëm në jetën tonë. Atëherë më lindi djali. Në atë vit Dita e Nënave ra më 1 maj, dhe drejtuesit tanë të asaj kohe vendosën që të mos jetë në të njëjtën ditë me festën e klasës punëtore, kështu që e vendosën zyrtarisht të djelën tjetër, më 8 maj. Fëmija ime i vogël mendoi që unë e meritoj këtë festë, prandaj lindi më 6 maj, kështu që edhe unë pata mundësinë të merrja lule! Dhe që atëherë kujdeset vashdimisht për mua.

Historia e festës së nënave fillon që në Greqinë e lashtë. Në vendin tonë festa e parë e tillë u zhvillua në vitin 1925, dhe që atëherë vjen çdo vit. As në të mos i harrojmë Nënën, Gjyshet!

Paleta e gjerë e produkteve të firmës sonë na jep mundësinë t'u bëjmë qejfin çdo lloj "mamaje". Bashkë me lulet të mos u japim ëmbëlsira, por shëndet dhe bukuri. Jemi në pranverë dhe së shpejti vjen vera, kujdesi për lëkurën është shumë i rëndësishëm. Për trajtimin e fytyrës ju rekomandoj paketën tonë Sonya Skin Care, e cila është një komplet trajtimi lëkure ditor i përbërë prej 5 produkteve. Por – në varësi të xhepit – mund të shkaktojmë kënaqësi edhe me kremin që hidraton thellë.

Po vjen sezoni i rrobave të banjës, kompleti ynë Body Toning Kit shërben mirë për përmirësimin e pamjes së përgjithshme të lëkurës.

Është i pafund numri i mundësive ku produktet tona mund të shërbyjnë si dhurata me vlerë.

Kalojnë ditët dhe erdhi e djela e fundit e majit, dita e fëmijëve.

Në vendin tonë kjo filloi të festohet në vitin 1931, atëherë quhej java e fëmijëve. Më lejoni t'ju tregoj përsëri një diçka personale: Nëna ime ka lindur më 25 prill 1931, kështu që java e parë e fëmijëve hungarez ishte festë edhe në familjen tonë.

Tek ne festat janë të rëndësishme, tek familja e madhe Forever gjithashtu. Çfarë mund t'u japim të vegjëlve tanë krahas çokolletës, ose në vend të saj? Duke menduar verën që po afron ta mbrojmë lëkurën e tyre me kremin kundër diellit të FLP-s, kurse vitamina e fëmijëve është një plotësues ushqimor i shkëlqyer. Fëmijë, ju dua shumë!

Numri i produkteve tona është i pafund, të gjitha shkaktajnë buzëqeshje në fytyrën e të dashurve tanë. Ju lutem zgjidhni!

Përsëndes me dashuri krahas të dashurve të mi gjithë Nënën, Gjyshet dhe Fëmijët.

Falenderime të singerta:

Kata Ungar

FOREVER

IMRPRESSUM

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk.

Redaksia: FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Dr. Sandor Milesz Redaktor: dr. Csaba Gothárd, Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk.

Koordinator projekti: Szilvia Timar Redaktor leximi: Zita Kempf Korrigjues: Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati

Fotograf: Robert Laszlo Bacsí, The Digital Paparazzi

Përkthim, redaktim: Dr. Marsel Nallbani (shqip), Darinka Aničić, Žarko Anić Antić (kroat), Ottilia Toth-Kasa, Balazs Molnar, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven).

Shtypshkronja: Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 39180 kopje.

Për përbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.flpseeu.com



FOLEJA E SHQIPONJAVE, RESTORANTI I FOREVER-IT!

Ha drekë dhe darkë tek ne, ju presim me zgjedhje të larmishme dhe çmime të favorshme! Organizo tek ne takimet e tua, këtu mund ta ndërtosh biznesin tënd në një ambient të qetë e të këndshëm pranë një kafeje apo çaji të ngrohtë!



**JE I FTUAR
TEK NE**
PËR NJË UJË MINERAL SIRONA
OSE NJË KAFE EKSPRES!*



* Deri më 30 prill për çdo ushqim të ngrënë sipas dëshirës suaj ju japim falas një ujë mineral Sirona ose kafe ekspres!

Produktet e zgjoit të bletës



Forever Bee Pollen®

A poleni është pjalmi i pllenuar. Bletët e mbledhin dhe e çojnë në zgjua si ushqim. Pa polen nuk do të ekzistonin bimët, pemët, lulet, madje prej tij varen edhe njerëzit.

Forever Bee Pollen mblidhet me ndihmën e mjeteve mbledhëse prej çeliku pa ndryshk nga bimë të cilat gjenden në zona të shkreta e të thata. Kjo siguron plotësuesin ushqimor natyror më të pastër, më të freskët dhe më efektiv.

Forever Bee Pollen është plotësisht i natyreshëm, nuk përmban lëndë konservuese, lëndë artificiale për ngjyrosje dhe shije. Bee Pollen me shkallën e gjerë të lëndëve të tij vepruese ndihmon në ruajtjen e shëndetit.

Përmban vitamin C dhe kompleksin e vitaminave B. Meqë tretet në ujë mund të konsumohet përditë. Përmban edhe vitamin D, E, K, beta-karotin (vitamin A), shumë lëndë minerale, enzima, koenzima, karbohidrate, proteina dhe 22 aminoacide – duke përfshirë edhe 8 aminacidet esenciale të cilat organizmi nuk mund t'i sintetizoj dot vetë. Bee Pollen është një nga ushqimet më komplekse. Përmban edhe lecitin. 100 tableta (50 g)

PËRBËRËSIT

Pjalm i granuluar (86%), mjaltë, lëndë ndriçuese (acid stearik), lëndë tretëse (dioksid silici), rojal jelly.

Një tabletë përmban 430 mg pjalm.

MËNYRA E PËRDORIMIT:

Për herë të parë konsumoni ¼ tabletë në ditë për t'u bindur që nuk jeni alergjik ndaj tij, pastaj rriteni vazhdimisht dozën në maksimum 1 tabletë në ditë. Para përdorimit të tabletës këshillohuni me mjekun tuaj.

KUJDES!

Pjalmi u shkakon alegji njerëzve të ndjeshëm ndaj tij. Produkti nuk duhet të përdoret nga alergjikët ndaj pjalmi.

Mos e tejkaloni sasinë e rekomanduar në mënyrën e përdorimit!



- Plotësues ushqimor i rëndësishëm
- Përmban shumë vitamina dhe lëndë minerale
- Në të gjenden të gjitha aminoacidet esenciale
- Produkt me cilësi të shkëlqyer, i liofilizuar, pa lëndë ndotëse

PRODUCT #026